



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2020:051140  
Datë: 07.03.2022  
Numri i dokumentit: 02784224

C.nr.995/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti I Përgjithshëm, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditëses S.B nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kaqusha Avdiu-Sylejmani avokate nga Gjilani, Rr.“ Marie Shllaku” p.nr., ndaj të paditurës K. Gj..., me objekt kontesti, kompensimi i pagës jubilarë, shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të punës dhe shpenzimeve të udhëtimit, me vlerë të kontestit 1,558.70 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të mbajtur me datë 01.02.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.B nga K. Gjilani, dhe Obligohet e paditura që paditëses t'ia paguaj:

- në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune në vlerë të 50% të një page bazë (421 €), shumën në lartësi prej 210.50 € (dyqindë e dhjetë euro e pesëdhjetë cent);
- në emër të kompensimit për ushqim për 532 ditë pune, për periudhën kohore (nga data 18.04.2017 e deri më datë 28.04.2021), shumën e të hollave në lartësi prej 1,064.00 € ( njëmijë e ghatëdhjetë e katër euro);
- në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 203 ditë punë nga 2€ në ditë, apo 70% të biletës së trafikut urban shumën prej 274.20 € (dyqindë e shtatëdhjetë e katër euro);
- Gjithësej shumën e përgjithshme prej 1,558.70 € (njëmijë e pesëqindë e pesëdhjetë e tetë euro), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, tërë këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

II.OBLIGOHET e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 270 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Fillimisht paditësja në këtë gjykatë më datë 10.04.2020, përmes të autorizuarës së saj, ka ushtruar padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e saj dhe të obligohet e paditura që paditëses t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar mbi 13 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, respektivisht shumën prej 210.5 euro, në emër të kompensimit të ushqimit në punë shumën prej 1,792 € si dhe në emër të kompensimit për shpenzime të rrugës shumën prej 258.30 kurse me parashtrësën e datës 16.12.2021 dhe në shqyrtimin gjyqësor të dates 01.02.2022 ka bërë ndryshimin e kërkesëpadiës, ashtu që tani e tutje ka kërkuar nga gjykata që detyrohet e paditura që paditëse S.B nga Gjilani, t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune në vlerë të 50% të një page bazë, shumën e të hollave në lartësi prej 210.5 €, në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më datë 28.04.2021, shumën e të hollave në lartësi prej 1,064.00 euro ( për 532 ditë pune), në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 203 ditë pune nga 2€ apo 70% të biletës së trafikut urban, shumën prej 274.20, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,558.70 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, tërë këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më datë 18.09.2020, ku e paditura aktvendimin së bashku me padinë ka pranuar më datën 28.09.2020 e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës së gjykatës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do ti ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, për mundësinë që gjykata të marrë aktvendim për shkak të mosbindjes.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për arsye se paditësja kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e miratuar dhe nënshkruar nga MASHT dhe SBASHK respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 8 dhe nenit 35 pika 6 dhe 7 të kësaj kontrate, gjersa ka konsideruar se kjo kontratë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunes së Gjilanit, si e paditur në këtë rast. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë nuk është në fuqi për disa arsye konkrete: Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti i datës 06.05.2014, nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadiës dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Tutje ka theksuar se kjo kontratë kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Pagat jubilarë sipas Kontraës Kolektive të Arsimit mund të realizohen pas çdo 10 viteve dhe se afati i realizimit të kësaj kërkesë është 30 ditë nga koha e të drejtës për kompensim, ndërsa në rastin konkret kemi tejkallim të afatit ligjor të realizimit të kësaj kërkesë d.m.th. paditësi nuk e ka kërkuar realizimin e kësaj kërkesë në afat prej 30 ditësh. Përveç tjerave, e paditura ka theksuar se sipas nenit 90 pika 8 e Ligjit të Punës, për të qenë

kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartëcekur, dhe në fund ka shtuar se nuk janë shtjerrë mjetet juridike sipas procedurës administrative me qëllim që të inicohet procedura gjyqësore për realizimin e të drejtës së paditëses, andaj nga këto arsye ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar.

Shqyrtimi gjyqësor i datës 01.02.2022 është mbajtur me propozimin e të autorizuarit të paditëses në mungesë të të paditurës K. Gj, për arsye se e njëjta ftesën për seancë e ka pranuar në mënyrë të rregullt, nuk ka prezentuar në seancë dhe mungesën e saj nuk e ka arsyetuar.

I autorizuari i paditëses si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë thënieve në padi dhe kërkesëpadi, si dhe ndryshimit të saj përmes parashtrësës së datës 16.12.2020, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë, duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e saj dhe të obligohete paditura që paditëses, t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune në vlerë të 50% të një page bazë, shumën e të hollave në lartësi prej 210.5 €, në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më dt.28.04.2021, shumën e të hollave në lartësi prej 1,064.00 euro ( për 532 ditë pune), në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 203 ditë punë nga 2€ apo 70% të biletës së trafikut urban, shumën prej 274.20, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,558.70 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, tërë këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Gjithashtu e njëjta i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Kontrata e punës në kohë të pacaktuar me numër të port.710 e datës 01.09.2015 e lëshuar nga e paditura paditëses; Vërtetimi me numër 217/2 i datës 31.01.2020 i lëshuar nga SHFMU "S.." në .., për përvojën e punës të paditëses; Vërtetimi me numër 418 i datës 28.04.2021 i lëshuar nga SHFMU "S" në për përvojën e punës të paditëses; Vërtetimi me nr... i datës 07.02.2020 i lëshuar nga SHFMU "S.." , për orët në javë në këtë shkollë; Vërtetimi me nr.... i dt.06.08.2009 i lëshuar nga SHFMU "R...." në Gjilan për marrëdhënien të punës të paditëses; Vërtetimi me nr.423/2 i dt.28.04.2021 i lëshuar nga SHFMU "S.... " në ... për ditët e udhtëimit të paditëses; Çmimorja e SHTU "A.." me nr.23 e datës 05.03. 2020; Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në emër të paditëses; Njoftimi me nr.... i datës 07.02.2020 i lëshuar nga SHFMU "S..." në .... me të cilën vërtetohet se shkolla nuk ka kuzhinë brenda objektit të saj; Kuponat fiskal të lëshuar nga N.P.T."A..." dhe P.....; Çertifikata e vendbanimit me nr.serik B ... e datës 24.01.2020, si dhe formulari për kërkese drejtuar të paditurës e datës 12.02.2020.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-ës si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Se paditësja S.B është mësimdhënëse e gjuhës angleze në SHFMU "S..." në ..... fillimisht ka filluar punën në SHFMU "R...." në Gjilan nga data 01.09.2007 e pastaj ka filluar në SHFMU "S...." në fshatin .... nga data 01.09.2009 dhe

vazhdon të punoj edhe më tutje në këtë shkollë, fakt ky i vërtetuar nga Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me nr. prot.... e datës 01.09.2015.

-Nga Vërtetimi me numër ..... i datës 31.01.2020 i lëshuar nga SHFMU “S....” në ... për përvojën e punës të paditëses gjykata vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura prej datës 01.09.2009 dhe vazhdon të punojë ende me 20 orë në lëndën e gjuhës Angleze.

-Nga Vërtetimi me nr.482 i datës 06.08.2009 i lëshuar nga SHFMU “R..” në Gjilan për marrëdhënien e punës të paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune në këtë shkollë nga data 01.07.2007.

-Nga Vërtetimi me nr..... i datës 28.04.2021 i lëshuar nga SHFMU “S..” në P....., për ditët e udhëtimit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka udhtuar gjatë ditëve të punës nga data 18.04.2017 e deri më 28.04.2021 gjithësej 203 ditë pune .

-Nga Vërtetimi me numër ..... dt.28.04.2021 i lëshuar nga SHFMU “S.....” në ..., për ditët e pranisë në punë gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka gjithësej 531 ditë prani në punë nga data 18.04.2017 e deri më datën 28.04.2021.

-Nga Çmimorja e SHTU “A....” me nr.23 e datës 05.03. 2020, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës në relacionin Gjilan -..... dhe Gjilan -.... dhe anasjelltas kushton 2 euro.

-Nga Njoftimi me nr.242.2 i datës 07.02.2020 i lëshuar nga SHFMU “S....” ....., gjykata vërtetoi faktin se shkolla në të cilën punon paditësja nuk ka kuzhinë brenda objektit të saj.

-Nga Kuponat fiskal të lëshuar nga N.P.T.”A.....” dhe P....., gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës në relacionete përmendura kushton 50 cent.

-Nga Çertifikata e vendbanimit me nr.serik B ..... e datës 24.01.2020 e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Gjendjes Civile ne Gjilan, e datës 24.01.2020 gjykata vërtetoi faktin se paditësja jeton në fshatin ..., Komuna e Gjilanit.

-Nga Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës në emër të paditëses, gjykata vërteton faktin se paditësja pagën neto e ka 447.94 €.

-Njoftimi me nr.242.2 i dt.07.02.2020 e lëshuar nga SHFMU “S....” në fsh. .., me të cilën njoftohet se shkolla nuk ka kuzhinë brenda objektit të saj, gjykata vërtetoi faktin se paditësja pagën bazë ka 421 euro.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësës dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, konkretisht nenin 35 par. 5 , 7 dhe nenin 8 pika 8.1 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimroe në fuqi.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi që të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses S.B nga Gjilani, duke e obliguar të paditurën që paditëses, t'i paguaj në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune në vlerë të 50% të një page bazë, shumën e të hollave në lartësi prej 210.5 €, në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më dt.28.04.2021, shumën e të hollave në lartësi prej 1,064.00 euro ( për 532 ditë pune), në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 203 ditë punë nga 2€ , apo 70% të biletës së trafikut urban shumën prej 274.20, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,558.70€, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, tërë këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit parauniversitare të datës 18.04.2017, ku në nenin 35 par. 8 shprehimisht është përcaktuar se “ *Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: kurse pika 8.1 parasheh “Për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë dhe neni 8.5 ku shprehimisht parashihet se “Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi kur i punësuarit i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse”, ndërsa neni 35 par.7, të po kësaj kontrate ku është përcaktuar se “Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arismore.Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restauranit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim, në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restauranteve, dhe nenin 35 par.7 ku shprehimishta parashihet se: “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban,” andaj edhe e obligoj të paditurën që paditëses t’ia kompesoj edhe shumën e lartëcekur në emër shpërblimit jubilar në emër të ushqimit si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit.*

Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligjinr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se „Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”. Kurse Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon çështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktit administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ mardhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës e më pastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurse siq dihet

të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Gjykata poashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/*Kontrata nr.24. edatës 18.04.2017/*, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës ku ka cekur se Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës nuk prodhon efekt për të paditurën, dhe e njëjta ka skaduar, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03L-068, ku në nenin 35 pikat 5, 7 dhe 8 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe drejtorëve si dhe pagesës së tyre, e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të paditurës.

Kamata ligjore prej 8% në vitë është përcaktuar konform nenit 382 të LMD, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se „*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, kurse lartësia e kamatë vonësës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi konform nenit 452.1 të LPK-s që ta obligojë të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës edhe atë; për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për taksë gjyqësore shumë prej 31€ si dhe për një përfaqësim në një seancë shumë e të hollave në lartësi prej 135€, respektivisht shumë e përgjithshme prej 270€.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, e konform nenit 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjilan -Departamenti I Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.995/20, me datë 01.02.2022

Gjyqtarja,  
Florije Qerimi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.